



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës,
Trajtimit ose Dënimit të Egër, Çnjerëzor ose Poshtërues

AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/317
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. K4/I35-2 Prot.
Nr. Dok. 202502686/2

Tiranë _27_/_08_/2025

Lënda: Rekomandime për inspektimin e kryer në Komisaratin e Policisë Kurbin

Drejtuar: Drejtues Madhor Z. Ilir PRODA
Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit

TIRANË

Z. Altin MENA
Drejtor i Drejtorisë Vendore të Policisë Lezhë

LEZHË

Z. Lenord NDREKA
Shef i Komisarimit të Policisë Kurbin

KURBIN

Të nderuar,

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin e deritanishëm midis institucioneve tona, si dhe duke vlerësuar angazhimin për punën e stafit të institucionit që ju drejtoni, në vijim po ju njohim mbi gjetjet e inspektimit që Institucioni i Avokatit të Popullit kreu në Komisaratin e Policisë Kurbin më datë 30.04.2025.

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues, seksion pranë Avokatit të Popullit, në vijim Mekanizmi Kombëtar (MKPT), bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, kreu një inspektim në ambientet e privimit të lirisë së personit në Komisaratin e Policisë Kurbin.

Inspektimi u krye sipas një Plani Vjetor Inspektimi të miratuar nga Avokati i Popullit. Në përbërje të grupit inspektues ishin z. Hazbi Selita dhe z. Vullnet Topalli me detyrë Nd/Komisionerë pranë Mekanizmit Kombëtar.

Qëllimi i inspektimit ishte vlerësimi i përgjithshëm i respektimit të të drejtave themelore të të arrestuarve, të ndaluarve dhe të shoqëruarve, të cilat ju garantohen me Kushtetutën e

Republikës së Shqipërisë, Kodin e Procedurës Penale, ligjin nr. 82/2024 “Për Policinë e Shtetit”, si dhe me standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave themelore të personave të privuar nga liria. Inspektimi ishte i paparalajmëruar.

Bazuar në legjislacionin vendas dhe standardet ndërkombëtare, MKPT mund të vizitojë në çdo kohë dhe pa paralajmërim, të gjitha vendet ku mbahen personat e privuar nga liria, përfshirë organet e policisë në nivel vendor, burgjet, qendrat e pritjes provizore të migrantëve të parregullt, qendrat ku mbahen shtetasit e huaj të privuar nga liria dhe azilkërkuesit, si dhe institucionet psikiatrike e shtëpitë e të moshuarve.

Në këtë kuadër, grupi i inspektimit verifikoi zbatimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të shoqërimit nga punonjësit e policisë të komisariatit, inspektoi ambientet që ndodhen në mjedisin e shoqërimit, u kontrollua dokumentacioni që ndodhej në zyrën e informacionit, si dhe procedurat që ndjekin punonjësit e policisë sipas kërkesave të parashikuara në procedurat standarde të punës *“Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”* miratuar me Urdhrin nr. 894, datë 19.07.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, si dhe u verifikua gjithashtu edhe zbatimi i rekomandimeve të MKPT-së nga inspektimi i mëparshëm i kryer në ambientin e shoqërimit të Komisarariatit të Policisë Kurbin¹.

Shënime të përgjithshme

Në përputhje me metodologjinë e zhvillimit të inspektimit në institucionet ku mbahen e trajtohen shtetas të privuar nga liria, në mungesë të Shefit të Komisarariatit, grupi i punës u takua me Shefin e Sektorit për Rendin dhe Sigurinë në Komisariatin e Policisë Kurbin, z. Fatos Cera i cili u vu në dijeni lidhur me qëllimin e inspektimit.

Shefi i Sektorit për Rendin dhe Sigurinë në Komisariatin e Policisë Kurbin, informoi grupin e inspektimit për kushtet në të cilat ndodhet ambienti i shoqërimit, angazhimin e punonjësve të policisë për garantimin dhe mbrojtjen e të drejtave ligjore të personave të privuar nga liria në këto ambiente, si dhe masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit nga inspektimi i mëparshëm.

Grupi inspektues, pasi mori informacionin e nevojshëm, i shoqëruar nga Shefi i Sektorit për Rendin dhe Sigurinë, inspektoi në vend gjendjen e dhomave të shoqërimit, kushtet infrastrukturore dhe materiale të tyre, si dhe u njoh dhe administroi kopje të dokumentacionit ku pasqyrohen veprimet e kryera me personat e shoqëruar, si dhe vizitoi zyrat e punës së oficerëve të Policisë Gjyqësore, në lidhje me praninë e sendeve

¹ Shkresë nr. K4/I41-2 prot., datë 08.08.2024 *“Rekomandim për inspektimin e kryer në ambientin e shoqërimit të Komisarariatit të Policisë Kurbin”*.

që ekspozojnë dhunë gjatë kryerjes së veprimeve procedurale për marrjen në pyetje të personave të shoqëruar.

Nga informacioni i grumbulluar në vend gjatë kryerjes së inspektimit, rezultoi se gjendja faktike e ambientit të shoqërimit ishte thuajse e njëjtë si në inspektimin pararendës, ballafaquar me standardet e parashikuara në aktet normative dhe dokumentet ndërkombëtare për respektimin e të drejtave të personave të shoqëruar, brenda këtyre ambienteve.

Theksojmë se, shefi i Sektorit për Rendin dhe Sigurinë dhe punonjësit e tjerë të policisë, me të cilët kontaktoi grupi i inspektimit u treguan bashkëpunues gjatë inspektimit.

Në Komisarlatin e Policisë Kurbin, nga informacioni i grumbulluar gjatë kryerjes së inspektimit në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin e kaluar², rezultoi se:

1. Ishte zbatuar rekomandimi, për plotësimin me korrektësi të rubrikës “*Njoftimi i familjarëve*” tek regjistri i personave të shoqëruar dhe evidentimi i tyre në këtë regjistër.
2. Ishte zbatuar rekomandimi, për pajisjen me një regjistër për evidentimin e kërkesë/ankesave të personave të shoqëruar, të arrestuar dhe të ndaluar, sikurse parashikohet në nenin 24 të ligjit nr. 82/2024 “Për Policinë e Shtetit”, në Komisarlatin e Policisë Kurbin.
3. Ishte zbatuar rekomandimi, për vendosjen e posterave me të drejtat e personave të shoqëruar, në koridor dhe brenda ambienteve të dhomave të shoqërimit për të garantuar leximin dhe kuptimin e tyre nga të shoqëruarit.

Ndërkohë, grupi i inspektimit konstatoi se:

1. Nuk ishte zbatuar rekomandimi, për mbylljen e godinës ekzistuese në Komisarlatin e Policisë Kurbin, si dhe fillimin e punimeve për ndërtimin e Komisarlatit të Policisë Kurbin të parashikuar në PBA-në e vitit 2024.
2. Nuk ishte zbatuar rekomandimi, për krijimin e zyrës së intervistimit, për marrjen në pyetje të shtetasve gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e Policisë Gjyqësore dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në këto zyra.
3. Nuk ishte zbatuar rekomandimi, për ndërtimin e tualeteve të ndara për femra dhe meshkuj, si dhe të pajisur me mjetet e domosdoshme për këtë qëllim, brenda apo ngjitur me ambientin e shoqërimit të Komisarlatit të Policisë Kurbin.
4. Nuk ishte zbatuar rekomandimi, për sigurimin e sistemit të ngrohjes ose vendosjen e pajisjeve elektrike në dhomën e shoqërimit, për ngrohjen e këtyre ambienteve kryesisht në periudhën e dimrit.

² Kthim përgjigje të shkresës tonë nr. 7668/1 prot, datë 11.10.2024 nga Komisarlati i Policisë Kurbin.

5. Nuk ishte plotësuar rekomandimi, për afishimin ne ambientin e shoqërimit dhe në zyrën e informacionit të komisarariatit, të listës së avokatëve mbrojtës të miratuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë.

Nga informacioni i drejtuesve të institucionit, u evidentua përsëri problematikë në lidhje me godinën e Komisarariatit të Policisë Kurbin, e cila për shkak të dëmtimeve në strukturat e jashtme dhe të brendshme të saj nga tërmeti i datës 26 nëntor 2019, paraqiste mjaft probleme, ku një pjesë e e godinës ishte jashtë funksionit. Gjithashtu, u evidentua se struktura mbajtëse e godinës, muret dhe soleta janë shumë të dëmtuara dhe janë në prag të shembjes, dhe për këtë arsye administrata ishte zhvendosur në katin e parë të këtij institucioni, duke punuar në kushtet e rrezikshmërisë për jetën dhe shëndetin e punonjësve të Komisarariatit të Policisë Kurbin.

Gjithashtu, drejtuesit e Komisarariatit të Policisë Kurbin na informuan se kanë ardhur specialistët nga Drejtoria e Përgjithshme Policisë së Shtetit, ku kanë bërë dhe një raport konstatimi në lidhje me dëmtimet e godinës, por deri më sot nga ana e tyre nuk është marrë asnjë veprim konkret tjetër për këtë situatë.

Ndërkohë, nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit³ na është bërë me dije ndër të tjerat se: *“Kompania projektuese e përzgjedhur për hartimin e projektit për ndërtimin e Komisarariatit të Policisë Kurbin, ka përfunduar projektin dhe është në fazën e shqyrtimit dhe kryerjes së opionencës teknike nga Instituti i Ndërtimit. Pas kryerjes së opionencës teknike do të vijohet me përzgjedhjen e kompanisë së ndërtimit, për implementimin e projektit dhe ndërtimin e objektit të Komisarariatit të Policisë Kurbin”*.

Deri në implementimin e projektit për ndërtimin e Komisarariatit të Policisë Kurbin, Institucioni i Avokatit Popullit kërkon marrjen e masave të menjëhershme nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe institucionet e tjera përgjegjëse për mbylljen e Komisarariatit të Policisë Kurbin dhe zhvendosjen e administratës në një godinë tjetër për të qenë sa më funksionale në ofrimin e kushteve të përshtashme të stafit të këtij institucioni në shërbim të qytetarit, por dhe për të garantuar respektimin e të drejtave dhe lirive të tyre themelore, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, deri në ndërtimin apo rikonstrukcionin e plotë të kësaj godine.

Grupi i inspektimit, i kushtoi rëndësi të veçantë plotësimit të kushteve të jetesës, të dhomave të shoqërimit në Komisariatin e Policisë Kurbin, sipas kriterëve të përcaktuara në procedurat standarde të miratuara nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit për ndërtimin e tyre, si dhe trajtimin e shtetasve në këto mjedise, në bazë të akteve ligjore dhe akteve ndërkombëtare që garantojnë të drejtat e tyre.

Ambientet e shoqërimit dhe kushtet e tyre

³Kthim përgjigje të shkresës tonë me numër 7668/1 prot., datë 11.10.2024 nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.

Në Komisarlatin e Policisë Kurbin, ambienti i shoqërimit ishte ndërtuar në tërësi sipas kushteve dhe kriterëve të mbajtjes dhe qëndrimit të personave të shoqëruar, sikurse përcaktohet në procedurën standarde *“Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”*, miratuar me Urdhrin nr. 894, datë 19.07.2022, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit⁴.

Mjedisi i shoqërimit ndodhet në një ndërtesë më vete nga godina kryesore e komisarlatit. Kjo ndërtesë ishte në gjendje të mirë. Ambienti i shoqërimit përbëhej nga 3 (tre) dhoma shoqërimi të ndara më vete, 1 (një) dhomë shoqërimi për personat e rritur, 1 (një) dhomë për femra dhe 1 (një) dhomë për të mitur⁵.

Dhomat e shoqërimit kishin hapësirë dhe sipërfaqe të bollshme dhe ishin të pajisura me tavolina dhe me karrige për qëndrimin ulur të personave të shoqëruar. Përmasat e dhomave të shoqërimit ishin 4mx3m dhe kishin kapacitet për mbajtjen dhe qëndrimin ulur deri 4 persona për secilën dhomë.

Dhomat e shoqërimit kishin dritare, përmasat e së cilave siguronin ndriçim të nevojshëm natyral. Të treja dhomat gjithashtu kishin ndriçim artificial nga rrjeti elektrik. Dyert ishin prej druri, të cilat kishin mundësi për t'u mbyllur nga jashtë. Në përgjithësi të 3 dhomat ishin të pastra nga ana higjieno-sanitare. Në këto ambiente nuk kishte sistem ngrohje/ftohjeje.

Në Komisarlatin e Policisë Kurbin **nuk kishte tualete të ndara më vete për gra dhe burra**⁶ sipas parashikimeve në procedurën standarde *“Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”*, miratuar me Urdhrin nr. 894, datë 19.07.2022, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit ku në pikën e.2 përcaktohet se: *“Pranë dhomave të shoqërimit dhe ngjitur me to, ndërtohen dhe funksionojnë tualetet për kryerje të nevojave personale të ndara për femra dhe meshkuj, me sipërfaqe të mjaftueshme për vendosjen e pajisjeve përkatëse dhe funksionimin për qëllimin që kanë me sipërfaqe 6 – 8 m2. Tualetet mund të ndërtohen brenda dhomës së shoqërimit (pa cenuar sipërfaqen e dhomës së shoqërimit) ose më vete në korridor dhe pranë dhomave të shoqërimit”*. Ndërkohë të shoqëruarit përdornin tualetin, i cili përdorej edhe nga punonjësit e policisë të këtij komisarlati.

Në korridoret e dhomave të shoqërimit ishte e instaluar 1 kamera për mbajtjen në vëzhgim të këtij ambienti, por ato mungonin brenda dhomave të shoqërimit për monitorimin e personave të shoqëruar në këtë insitucion. Instalimi i sistemit të kamerave të sigurisë

⁴ Kreu VI, pika 4, gërmat b dhe c *“Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”*, miratuar me Urdhrin nr.894, datë 19.07.2022, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

⁵ Kreu VI, pika 3 e procedurës standarde *“Rregullat teknike të shoqërimit në polici”*.

⁶ Kreu VI, pika 4, gërma e, pika e.2 e procedurës standarde *“Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”*, miratuar me Urdhrin nr. 894, datë 19.07.2022, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

brenda dhomave të shoqërimit do të shërbejë për mbajtjen në vëzhgim të dhomave të shoqërimit, si dhe do të monitorojë veprimet që kryejnë punonjësit e policisë me personat e shoqëruar gjatë kryerjes së procedurave që nga hyrja në mjediset e policisë, qëndrimit në dhoma, si dhe gjatë marrjes në pyetje të tyre.

Në kushtet e vendndodhjes së komisariatit, si dhe për të garantuar sigurinë e personave të shoqëruar, është i domosdoshëm instalimi i sistemit të kamerave në ambientet e brendshme të dhomave të shoqërimit siç parashikon Urdhri i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 894, datë 19.07.2022 procedurat standarde *“Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”*, ku thuhet se: *“Të gjitha ambientet e shoqërimit monitorohen me sisteme të kamerave (përjashto tualetin), si ambientet e brendshme të dhomave të shoqërimit, korridori i tyre dhe pjesa e jashtme e dhomave të shoqërimit, të cilat lidhen dhe trasmentojnë pamje/imazhe në monitor të vendosur në ambientin e shoqërimit të sallës së komandimit/shërbimit të informacionit DPV komisariate, stacione policie”*.

Sipas strukturës, Komisariati i Policisë Kurbin kishte në organikë 5 specialistë policie/OPGJ dhe 8 specialistë SPZ. Nga këqyrja e zyrave të specialistëve të policisë/OPGJ dhe ndihmës/specialistëve të policisë/SPZ, nuk u gjetën sende apo mjete, prania e të cilave të ekspozonte dhunë ndaj shtetasve që intervistohen/merren në pyetje në zyrat e tyre.

Në Komisarlatin e Policisë Kurbin, kishte një magazinë me vete, e cila shërbente si dhomë e marrjes së provave materiale dhe sipas informacionit të drejtuesve të komisariatit provat materiale futen në një qese të etiketuar në këtë ambient⁷, ose në rast të ekzaminimit dërgohen në zyrat e provave materiale në Drejtorinë Vendore të Policisë Lezhë.

Në ambientin e shoqërimit ishin vendosur postera me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar. Gjithashtu, në posterat përkatës ishte pasqyruar edhe e drejta ligjore e personave të shoqëruar për të paraqitur ankesa.

Gjithashtu, na u bë me dije se personat e shoqëruar nga policia janë informuar për të drejtat e tyre, që nga fillimi i privimit të lirisë, duke siguruar informacion të qartë verbal në lidhje me të drejtat ligjore/procedurale që ata kanë⁸. Përveç sa më sipër, Avokati i Popullit inkurajon pajisjen e qytetarëve me *“Kartën e të drejtave”* në rast shoqërimi në polici, që është një dokument me të cilin duhet të njihet çdo qytetar që shoqërohet në një komisariat policie. Nëpërmjet *“Kartës së të drejtave”* qytetari informohet mbi të drejtat e tij përballë

⁷ Neni 215 i Kodit të Procedurës Penale *“Vulosja e sendeve të sekuestruara”*.

⁸ CPT u bën thirrje autoriteteve shqiptare të ndërmarrin hapa për të siguruar që personat e ndaluar nga policia të jenë plotësisht të informuar për të drejtat e tyre që nga fillimi i heqjes së lirisë (domethënë, nga momenti kur ata janë të detyruar të qëndrojnë në polici). Kjo duhet të sigurohet me dhënien e informacionit të qartë verbal që në fillim, për t'u plotësuar në rastin më të shpejtë (domethënë, menjëherë pas mbërritjes në ambientet e policisë) me sigurimin e fletës së informacionit të lartpërmendur. Personave në fjalë duhet t'u kërkohet të nënshkruajnë një deklaratë që vërteton se ata kanë marrë një kopje të fletës së informacionit. Raporti CPT-së për Shqipërinë CPT/Inf (2019) 28 [par.24]. Konsulto: <https://rm.coe.int/168097986b>.

institucionit të Policisë së Shtetit në mënyrë që të jetë i ndërgjegjshëm për çdo formë abuzimi apo tejkalimi të kompetencave të punonjësve të policisë kundrejt tij.

Vendosja në dispozicion të çdo qytetari të “Kartës së të Drejtave” është një standard të cilin Avokati i Popullit kërkon vazhdimisht që të respektohet. Gjithashtu, edhe Komitetit European për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin Çnjerëzor dhe Degradues CPT-ja, përshëndeti zhvillimin e kësaj praktike për kartën edhe thellimin e saj, duke kërkuar që punonjësit në zyrën e pranimi të sigurohen që të shoqëruarit që shkruajnë e lexojnë, e kuptojnë përmbajtjen e kartës së të drejtave.

Në Komisarlatin e Policisë Kurbin gjatë periudhës **01.01.2025** deri më **28.04.2025** ishin të shoqëruar dhe të evidentuar në regjistrin e shoqërimit **65** persona, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 19 dhe 25/1 të ligjit nr. 82/2024 “Për Policinë e Shtetit”, ku saktësisht ishin të shoqëruar **62** shtetas madhorë burra, **1** grua dhe **2** të mitur në konflikt me ligjin. Në momentin e inspektimit **nuk kishte asnjë shtetas** në dhomat e shoqërimit.

Nga verifikimi i regjistrin të marrjes dhe dorëzimit të personave të shoqëruar dhe kopjeve të procesverbalit të veprimeve të kryera nga punonjësi i policisë me personin e shoqëruar, në rubrikën me shënimet në lidhje me ankesat/kërkesat e të shoqëruarve rezultoi se, për vitin 2025 nuk kishte asnjë ankesë të regjistruar.

Gjatë inspektimit u konstatua se në këtë komisarlat zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në nenin 19/5 dhe 25/5 të ligjit nr. 82/2024 “Për Policinë e Shtetit”, si dhe në kapitullin VII, pika a.3.4 të procedurave standarde për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimin e çështjes përkatëse.

Më tej u evidentuan disa praktika të njëpasnjëshme ku rezultoi se, në përfundim të procedurave dhe veprimeve të kryera nga punonjësit e policisë të komisarlatit, mbaheshin procesverbalet përkatëse dhe një kopje e firmosur i jepej personit të shoqëruar.

Ambientet e sigurisë dhe kushtet e tyre

Në Komisarlatin e Policisë Kurbin nuk kishte ambiente të sigurisë dhe personat e arrestuar/ndaluar, në përfundim të veprimeve procedurale nga ana e punonjësve të policisë, dërgoheshin menjëherë në dhomat e sigurisë të Komisarlatit të Policisë Lezhë.

Regjistri i personave të shoqëruar, si dhe trajtimi i të shoqëruarve

Gjatë inspektimit u konstatua se në Komisarlatin e Policisë Kurbin, “Regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar” ishte i tipit “Model nr. 1” konform me procedurat standarde “Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë” miratuar me Urdhrin nr. 894, datë 19.07.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Të gjithë personat e shoqëruar në organin e policisë sipas dispozitave të

parashikuara në ligjin nr. 82/2024 “Për Policinë e Shtetit”, regjistroheshin në këtë regjistër nga punonjësit e zyrës së informacionit.

Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se, koha e qëndrimit në gjendje shoqërimi e shtetasve ishte e ndryshme **nga 1 orë deri në 5 orë** në raste të veçanta. Rubrikat e regjistrit ishin plotësuar në mënyrë korrekte, me përgjegjësi dhe saktësi nga punonjësit e policisë në zyrën e informacionit⁹ dhe ishte i sekretuar.

Në këtë komisariat kishte regjistër për evidentimin e kërkesë/ankesave të personave të shoqëruar, të arrestuar dhe të ndaluar, sikurse parashikohet në nenin 24 të ligjit nr. 82/2024 “Për Policinë e Shtetit”, por gjatë vitit 2025 nuk ishte evidentuar asnjë ankesë apo kërkesë nga ana e këtyre personave.

Gjithashtu, në këtë institucion administrohej regjistër për të miturit e shoqëruar në konflikt me ligjin¹⁰, ku evidentoheshin të gjithë rastet e të miturve të shoqëruar në këto ambiente, në të cilin u konstatua se të gjithë rubrikat e regjistrit ishin plotësuar në mënyrë korrekte dhe regjistri ishte i sekretuar. Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se gjatë muajit janar të vitit 2025 kishte vetëm 2 të shoqëruar të mitur në konflikt me ligjin, sipas procedurës standarde (Lidhja model 5).

"Formulari i Raportit të Shoqërimit" plotësohej gjithashtu nga punonjësi i policisë që kishte kryer shoqërimin e personit për në komisariat, sikurse përcaktohet në procedurën standarde.

Gjithashtu, *"Procesverbalin me veprimet e kryera nga punonjësi i policisë me personin e shoqëruar"*, në përfundim të veprimeve, kur shtetasi lihej i lirë, punonjësi i policisë e plotësonte atë në dy kopje, ku një kopje i jepej personit të shoqëruar, ndërsa kopja tjetër e procesverbalit, pasi administrohej nga punonjësi i informacionit, mbahej në dosje të veçantë dhe pas një jave dorëzohej në sekretari/arshivën e institucionit.

Në zyrën e informacionit, ndodhej edhe një regjistër për takimet me avokatin kur kërkohej nga të shoqëruarit, si dhe karta e të drejtave të personave të shoqëruar apo ndaluar/arrestuar në gjuhën shqipe dhe në disa gjuhë të huaja.

Avokati i Popullit thekson se plotësimi i regjistrave në kohë dhe me korrektësi është një standard thelbësor në funksion parandalues për të garantuar të drejtat e njeriut.

Ambientet e intervistimit

Në Komisaratin e Policisë Kurbin, nuk ka një dhomë më vete të monitoruar me sistemin e kamerave, që të shërbejë për intervistimin marrjen në pyetje të personave të shoqëruar nga punonjësit e policisë, për të cilët ekzistojnë kushtet e përcaktuara në ligj se ka dyshime

⁹ Kreu VII, e procedurave standarde “Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”.

¹⁰ Detyrim i përcaktuar nga ligji nr.37/2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”.

të arsyeshme që kanë kryer një vepër penale. Në mungesë të kësaj dhome, këta persona merren në pyetje në zyrat e punës të punonjësve të policisë. Këto ambiente, përsa kohë shërbejnë edhe si zyra intervistimi apo për marrjen në pyetje të të shoqëruarve në konflikt me ligjin, **nuk** ishin të monitoruara me kamera, për mbajtjen në vëzhgim të sjelljes dhe veprimeve procedurale që kryejnë oficerët e Policisë Gjyqësore me këta shtetas.

Krijimi i zyrave të veçanta ku merren në pyetje shtetasit gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e Policisë Gjyqësore dhe instalimi i sistemit të monitorimit me kamera në këto zyra, është rekomandim i përsëritur në vite nga Avokati i Popullit referuar standardeve ndërkombëtare¹¹, të cilat e konsiderojnë procesin e monitorimit filmik si një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga ana e të shoqëruarve, ndaluarve e arrestuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e Policisë së Shtetit, por ky rekomandim ende nuk është plotësuar.

Ky standard ka gjetur rregullim tashmë edhe në procedurat standarde “*Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë*”, miratuar me Urdhrin nr. 894, datë 19.07.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, duke u shndërruar në rregull të detyruar për strukturat qendrore dhe vendore të Policisë së Shtetit. Në këtë dokument shprehet qartë se, në mjedisin ku ndodhen dhomat e shoqërimit, duhet të krijohet dhe një dhomë për intervistimin/marrjen në pyetje të personave të shoqëruar para se të akomodohen/futen në dhomat e sigurisë të DVP/komisariatit të policisë (personat që do të arrestohen/ndalohen). Ky ambient përveç kushteve të përcaktuara për dhomat e shoqërimit duhet të plotësojë dhe kushtet për: “*Instalimin e sistemeve dhe pajisjeve për regjistrimin elektronik audio dhe video të të gjitha veprimeve procedurale që kryhen me personin e shoqëruar nga oficerët e Policisë Gjyqësore, para se personi të akomodohet në dhomat e sigurisë të DVP/komisariatit të policisë si i arrestuar/ndaluar*”¹². Dokumentimi elektronik i intervistimit të personave të shoqëruar është një masë tepër efikase për parandalimin e dhunës psikologjike.

Gjithashtu në raportin drejtuar Qeverisë Shqiptare mbi vizitën e CPT në Shqipëri të kryer në datat 4-15 maj 2023 është evidentuar qartë nevoja e krijimit të dhomave të intervistimit¹³ ku citohet se: “*Në fakt, një strukturë e tillë mund të sigurojë një regjistrim të plotë dhe autentik të procesit të intervistimit, duke lehtësuar në masë të madhe hetimin*

¹¹ “Një sistem i monitorimit të vazhdueshëm i standarteve dhe procedurave të intervistave të policisë duhet vënë në zbatim, po ashtu; kjo kërkon një regjistrim të saktë të intervistave të personave në ambientet e policisë, të cilat, nëse është e mundur duhet të zhvillohen me pajisje regjistruese elektronike (audio dhe/video). Duhet të kërkohej që të regjistrohet në mënyrë sistematike koha kur ka filluar dhe mbaruar intervista, ndonjë kërkesë të bërë nga i ndaluari gjatë intervistës, si dhe të personave të pranishëm gjatë çdo interviste”. Raporti i CPT-së për Armeninë: CPT/Inf (2018) 31 [par.20]. <https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=09000016806bf46f>.

¹² Kreu VI, pika 4/i.1.1 të procedurave standarde “*Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë*”.

¹³ Electronic recording of police interviews (Regjistrimi elektronik i marrjes në pyetje nga ana e policisë) fq.13, <https://rm.coe.int/1680ae233b>.

e çdo pretendimi për keqtrajtim. Ky fakt është në interes si të personave që janë keqtrajtuar nga policia, ashtu edhe të punonjësve të policisë që janë përballur me pretendime të pabaza se janë përfshirë në keqtrajtme fizike apo presione psikologjike.

Në parim, regjistrimi audio-vizual duhet të mbulojë të gjitha fazat e marrjes në pyetje nga policia, duke përfshirë dhënien e informacionit për të drejtat në fillim të intervistës. Kjo do të sigurojë që marrja në pyetje nga ana e policisë të kryhet në përputhje me ligjin dhe do të ndihmojë në parandalimin e çdo praktike të nënshtrimit të personave të ndaluar në marrje në pyetje joformale përpara marrjes në pyetje zyrtare”.

CPT inkurajon autoritetet shqiptare të zgjerojnë aplikimin e regjistrimit audio-vizual të intervistave të policisë për marrjen në pyetje të të gjithë personave të ndaluar.

Komisariati i Policisë Kurbin në kushtet aktuale nuk posedon hapësirë të posaçme për komunikimin apo intervistimin me persona të mitur¹⁴, ndaj MKPT e konsideron me rëndësi të veçantë faktin se bisedat me fëmijët dhe pyetja e tyre duhet të realizohen në një ambient që duhet të jetë i përshtatur në mënyrë të posaçme për zhvillimin e intervistimeve me fëmijët, pasi nga intervistimi i tyre në kushtet aktuale mund të shkaktohen pasoja të rënda deri në trauma tek të miturit që janë në konflikt me ligjin.

Ndihma juridike, psikologjike dhe mjekësore

Në këtë komisarariat, punonjësit e policisë zbatonin detyrimin ligjor të parashikuar në nenin 19/5 dhe 25/5 të ligjit nr. 82/2024 “Për Policinë e Shtetit”, si dhe në kapitullin VII, pika a.3.4 të procedurave standarde “Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”, për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë, që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimin e çështjes përkatëse.

Nga inspektimi rezultoi, se për personat e shoqëruar mbahej procesverbali tip “Formulari i raportit të shoqërimit ose ndalimit/arrestimit”. Njëkohësisht, zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në nenet 34/b, pika 2 dhe 251 të Kodit të Procedurës Penale, që të ndaluarit/arrestuarit duhet t’i jepet një kopje e procesverbalit të ndalimit/arrestimit.

Në dispozitat e parashikuara në Kodin e Procedurës Penale në nenet 34/a, gërma “c” dhe 34/b gërma “a”, si dhe në ligjin nr. 82/2024 “Për Policinë e Shtetit”, në pikën 4 të nenit 19, përcaktohet se: “Çdo shtetas në momentin e privimit të lirisë në mjediset e Policisë së Shtetit, ka të drejtë të komunikojë menjëherë me avokatin mbrojtës”.

¹⁴ Kreu VII, pika 2.1/k e procedurës standarde parashikon se: “I mituri në konflikt me ligjin gëzon të drejtat e parashikuara në Kodin e Procedurës Penale, si dhe të drejtat e posaçme të parashikuara në Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur. I mituri duhet të mbahet në dhoma/ambiente të ndarë nga personat madhorë dhe të ndarë nga të miturit e tjerë sipas gjinisë”.

Grupi i inspektimit konstatoi se në momentin e inspektimit, në dhomat e shoqërimit nuk kishte asnjë person të shoqëruar. Në mungesë të tyre, u intervistuan punonjësit e policisë që kryejnë veprime procedurale me personat e shoqëruar, ku rezultoi se, në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit madhorë nuk kishin mundësi financiare për të pajtuar avokat privat dhe kërkonin ndihmë juridike, atyre iu sigurohej asistencë ligjore apo mbrojtja me avokat, nga zyrrat e avokatisë që funksionojnë në qytetin e Lezhës.

Nga inspektimi u evidentua se, në zyrën e informacionit dhe ambientin e shoqërimit, nuk ishte e afishuar lista e avokatëve të miratuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë Tiranë. Nga informacioni, kjo listë **nuk** ishte dërguar në DVP Lezhë, e cila më tej duhet të vihet në dispozicion të komisariateve të policisë në varësi të saj.

Sipas informacionit, përgjithësisht avokati paraqitej në mjediset e policisë jo më vonë se 2 orë nga momenti i njoftimit nga personeli i shërbimit ose nga specialistët e policisë të ngarkuar për kryerjen e veprimeve procedurale me të shoqëruarin apo të arrestuarin e dyshuar për kryerjen e veprës penale. Në regjistrin ku evidentohen takimet e të shoqëruarve me avokatin mbrojtës, shënohej emri dhe mbiemri i avokatit, si dhe ora e takimit, por jo ora e njoftimit.

CPT gjatë vizitës inspektuese në Shqipëri të zhvilluar në periudhën 4-15 Maj 2023 në institucionet policore, në raportin dërguar autoriteteve të Qeverisë së Shqipërisë, përse i përket masave mbrojtëse themelore kundër keqtrajtimit të personit (përkatësisht, e drejta e njoftimit për ndalimin dhe e drejta për avokat dhe mjek), ka konstatuar se: *“Delegacioni dëgjoi disa pretendime se oficerët e policisë kishin pranuar kërkesat e tyre për avokat kryesisht vetëm **pas një vonese të konsiderueshme**, në mënyrë që të mund t’i pyesnin ata në mënyrë joformale për veprën e dyshuar pa praninë e një avokati. Gjithashtu janë marrë ankesa se **avokatët kryesisht nuk kanë ofruar ndonjë ndihmë kuptimplotë**. Për më shumë, informacioni i mbledhur gjatë vizitës sugjeronte se ekzaminimi fillestar mjekësor i personave të ndaluar në përgjithësi ishte ende i kufizuar tek pyetjet për gjendjen e tyre shëndetësore, pa kryer një ekzaminim fizik”*.

Përse më sipër, CPT ka rekomanduar se: *“Autoritetet shqiptare duhet t’u kujtojnë të gjithë oficerëve të policisë **detyrimin ligjor për t’i dhënë akses ndaj një avokati që nga fillimi i heqjes së lirisë së një personi**. Gjithashtu, duhet të ndërmerren hapa në konsultim me Dhomën e Avokatëve për t’u siguruar që avokatëve kryesisht t’u kujtohet **roli i tyre kyç në parandalimin e keqtrajtimit duke qenë të pranishëm në komisaritet e policisë dhe duke ndërhyrë që në fillim të privimit të lirisë, duke përfaqësuar sa më mirë të munden interesat e personave që janë të mandatuar të ndihmojnë dhe, më konkretisht, duke ndërmarrë veprimet e duhura sa herë që ka tregues se persona të tillë janë keqtrajtuar (ose mund të jenë) keqtrajtuar nga policia. Gjithashtu, duhet të ndërmerren hapa për të promovuar, në kuadrin e trajnimit fillestar dhe të vazhdueshëm të avokatëve, një kulturë ku **mosndjekja e akuzave për keqtrajtim policor të konsiderohet si joetike dhe joprofesionale**”¹⁵.***

¹⁵ efaidnbmnnnibpcajpcgclcfndmkaj/https://rm.coe.int/1680ae233b

Gjithashtu, u evidentua se në mjedisin e shoqërimit mungonte edhe lista e psikologëve e miratuar nga Urdhri i Psikologut në Tiranë. Pavarësisht kësaj, në rastet kur i shoqëruari apo i ndaluari/arrestuari ishte i mitur, psikologu sigurohej në bashkëpunim me shkollën e mesme të qytetit të Laçit.

Në rastet kur të shoqëruarit paraqesin probleme shëndetësore, ata i shoqërojnë në Qendrën Shëndetësore Laç, për të marrë ndihmën mjekësore.

Sa më sipër, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku parashikohet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”* dhe në bazë të nenit 21/b të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, i ndryshuar, ku përcaktohet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”*, me qëllim zgjidhjen e problemeve të konstatuara gjatë këtij inspektimi,

REKOMANDOJMË

1. Marrjen e masave të menjëhershme, për mbylljen e godinës ekzistuese në Komisaratin e Policisë Kurbin, pasi ajo nuk plotëson kushtet dhe kriteret që garantojnë një trajtim njerëzor dhe dinjitoz të tyre, të përcaktuara në ligjin nr. 82/2024 *“Për Policinë e Shtetit”*, dhe zhvendosjen e administratës në një godinë tjetër për të qenë sa më funksionale në ofrimin e kushteve të përshtatshme të stafit të këtij institucioni në shërbim të qytetarit, por dhe për të garantuar respektimin e të drejtave dhe lirive të tyre themelore, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, deri në ndërtimin apo rikonstruksionin e plotë të kësaj godine.
2. Marrjen e masave të menjëhershme, nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, për përshtetimin e procedurës në përzgjedhjen e kompanisë së ndërtimit dhe implementimin sa më parë të projektit të ndërtimit të godinës së Komisarimit të Policisë Kurbin, me qëllim për ta kthyer atë në një institucion me standarde bashkëkohore dhe dinjitoze, si për personat e shoqëruar, ashtu edhe për të garantuar kushte të përshtatshme pune për punonjësit e policisë së këtij institucioni.

Deri në realizimin sa më sipër, të zbatohen këto rekomandime:

1. Marrjen e masave të menjëhershme, për krijimin e zyrave për intervistimin/marrjen në pyetje të shtetasve, gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga specialistët dhe punonjësit e policisë në këtë institucion, sipas parashikimeve në Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 894, datë 19.07.2022 për miratimin e procedurave standarde *“Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”*, si dhe të ndërpritet praktika e

marrjes në pyetje të personave të shoqëruar në zyrat e punës të punonjësve të policisë të komisariatit.

2. Marrjen e masave për ndërtimin e tualeteve të ndara për gra dhe burra të pajisura me mjetet e domosdoshme për këtë qëllim sipas parashikimeve në procedurën standarde “*Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë*”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 894, datë 19.07.2022.
3. Marrjen e masave nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, për sigurimin e sistemit të ngrohjes ose vendosjen e pajisjeve elektrike në dhomat e shoqërimit, për ngrohjen e këtyre ambienteve kryesisht në periudhën e dimrit.
4. Marrjen e masave të nevojshme, për krijimin e zyrave të posaçme për intervistimin e personave të mitur, duke ofruar një ambient të përshtatshëm që duhet të jetë i rregulluar në mënyrë të posaçme për zhvillimin e bisedave me fëmijët.
5. Marrjen e masave të menjëhershme, për instalimin e sistemit të monitorimit me kamera vëzhguese brenda ambienteve të dhomave të shoqërimit në Komisaratin e Policisë Kurbin.
6. Marrjen e masave të nevojshme, për afishimin në ambientin e shoqërimit dhe në zyrën e informacionit të komisariatit, të listës së psikologëve të miratuar nga Urdhri i Psikologut, Tiranë.
7. Marrjen e masave të nevojshme, për afishimin në ambientin e shoqërimit dhe në zyrën e informacionit të komisariatit, të listës së avokatëve mbrojtës të miratuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë.
8. Marrjen e masave të menjëhershme, për dhënien e kartës së të drejtave në formë shkresore personave të shoqëruar që në momentin e hyrjes së tyre në komisariat.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, kërkojmë të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor, sipas nenit 22 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

**KOMISIONERI
i Mekanizmit Kombëtar
për Parandalimin e Torturës
(MKPT)**

Ahmet PRENÇI
d.v